ASCAP

ASCAP
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

MODUL KURRIKULAR

Kurrikula në Bazë Shkolle / me Zgjedhje në Arsimin e Mesëm të Lartë

"TË FOLURIT NË PUBLIK"

Koordinator: Erida Koleci, Ludmilla Stefani

www.ascap.edu.al

2026

1. HYRJE

Gjatë gjithë historisë së njerëzimit, të folurit në publik ka qenë një nga mënyrat më të rëndësishme për të ndarë ide dhe për të ndikuar te të tjerët. Në ditët tona, kjo formë komunikimi ka marrë një dimension të ri, duke u shtrirë përtej hapësirave tradicionale. Të folurit në publik nuk kufizohet më vetëm te prezantimet ose te fjalimet e drejtpërdrejta para dëgjuesve, por zhvillohet gjithnjë e më shumë në mjedise digjitale. Zhvillimi i mediave sociale dhe lehtësia e publikimit të përmbajtjeve kanë bërë që zotërimi i aftësive të prezantimit online të jetë tashmë i domosdoshëm, qoftë për një video në platformë digjitale, një prezantim në Zoom, një podcast etj.

Moduli "Të folurit në publik" trajton rëndësinë e të folurit në publik në kontekstin bashkëkohor, duke përfshirë si komunikimin tradicional ballë për ballë, ashtu edhe formatet digjitale ose online, dhe synon zhvillimin e këtyre aftësive gjatë zbatimit të tij në shkollë. Nxënësit do të analizojnë faktorët që ndikojnë në përgatitjen dhe realizimin e një fjalimi ose prezantimi cilësor, duke përdorur qasje moderne dhe mjete teknologjike. Për të siguruar një komunikim të suksesshëm, gjatë zhvillimit të modulit do të trajtohen tematika kyç, si: analiza e audiencës (fizike dhe virtuale), kërkimi dhe përzgjedhja kritike e informacionit, strukturimi i qartë i mesazhit dhe përdorimi i platformave digjitale. Gjithashtu, do t'u kushtohet rëndësi mjeteve të tilla si aplikacionet dhe programet e prezantimit, si dhe menaxhimit të ankthit dhe zhvillimit të vetëbesimit.

Moduli përfshin përdorimin e teknologjive të reja që po ndryshojnë mënyrën e të folurit në publik, si realiteti virtual për ushtrime në mjedise të simuluara dhe mjetet e inteligjencës artificiale për analizë dhe përmirësim të performancës. Gjatë zbatimit të tij, këto teknologji shfrytëzohen për të mbështetur nxënësit në përballimin e ankthit, forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e aftësisë për të strukturuar dhe përshtatur mesazhin sipas audiencës. Në këtë mënyrë, nxënësit krijojnë përvoja konkrete komunikimi dhe përmirësojnë gradualisht performancën e tyre në situata reale.

2. QËLLIMET E MODULIT "TË FOLURIT NË PUBLIK"

Ky modul është hartuar në përputhje me *ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i cili përcakton organizimin dhe funksionimin e

sistemit arsimor, si dhe strukturën e kurrikulës në arsimin parauniversitar. Sipas këtij ligji, institucionet arsimore kanë mundësinë të hartojnë ose të zbatojnë module në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle ose me zgjedhje, në përputhje me nevojat dhe interesat e nxënësve. Moduli mbështetet gjithashtu në *Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*, e cila vendos në qendër zhvillimin e kompetencave kyç, si dhe në *Planin Mësimor të Arsimit të Mesëm të Lartë (gjimnazit),* që parashikon hapësirë (orë mësimore) për zhvillimin e kurrikulës me zgjedhje ose të kurrikulës në bazë shkolle. Në këtë kontekst, moduli "Të folurit në publik" kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit, si dhe të kompetencave qytetare dhe personale.
Ky modul gjithashtu pasuron programet lëndore të fushës "Gjuhët dhe komunikimi", duke u përqendruar në zhvillimin praktik të aftësive të të folurit në situata reale komunikimi. Ai u përgjigjet synimeve të kurrikulës me zgjedhje ose të kurrikulës në bazë shkolle, e cila synon:

- ✓ plotësimin e nevojave dhe të interesave të nxënësve;
- ✓ zhvillimin e aftësive psiko-sociale;
- ✓ përgatitjen për jetën dhe orientimin për karrierën;
- ✓ përforcimin e njohurive dhe të aftësive të fituara në lëndët e kurrikulës bërthamë.

Rëndësia e këtij moduli në arsimin e mesëm të lartë është e veçantë, pasi kjo fazë përkon me formimin e identitetit të nxënësit si individ dhe si qytetar aktiv. Në këtë nivel, nxënësit përballen gjithnjë e më shumë me situata që kërkojnë komunikim publik: prezantime, diskutime, debate, intervista, pjesëmarrje në aktivitete sociale dhe komunitare. Të folurit në publik nuk është vetëm një aftësi gjuhësore, por edhe një aftësi jetësore, e cila zhvillohet përmes një procesi kompleks komunikimi. Ky proces përfshin:

- ✓ organizimin dhe strukturimin logjik të ideve;
- ✓ përshtatjen e mesazhit me audiencën;
- ✓ përdorimin e gjuhës së saktë dhe të përshtatshme;
- ✓ menaxhimin e emocioneve dhe të ankthit;
- ✓ përdorimin e elementeve joverbale dhe mjeteve mbështetëse.

Zhvillimi i kësaj aftësie ndikon drejtpërdrejt:

- ✓ në rritjen e vetëbesimit dhe të sigurisë;
- ✓ në zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues;
- ✓ në përmirësimin e ndërveprimit social dhe të komunikimit ndërpersonal;
- ✓ në përgatitjen për studime të mëtejshme dhe për tregun e punës;

- ✓ në fuqizimin e rolit të nxënësit si qytetar aktiv dhe i përgjegjshëm.

Qëllimet e këtij moduli janë që nxënësit:

- ✓ të kuptojnë dhe të vlerësojnë rëndësinë e të folurit në publik në jetën personale, shkollore dhe profesionale;
- ✓ të zhvillojnë aftësi për të ndërtuar dhe për të paraqitur mesazhe të qarta, të strukturuara dhe bindëse;
- ✓ të aftësohen si folës dhe dëgjues etikë, duke respektuar normat e komunikimit;
- ✓ të përdorin forma të ndryshme të fjalimeve dhe të prezantimeve në varësi të qëllimit dhe të audiencës;
- ✓ të fitojnë vetëbesim dhe pavarësi në shprehjen e ideve dhe të mendimeve të tyre.

Në përfundim të modulit, nxënësit pritet të demonstrojnë aftësi të mira komunikimi në kontekste të ndryshme publike, duke përdorur gjuhën në mënyrë të përshtatshme dhe të përgjegjshme.

3. PËRMBAJTJA E MODULIT



Ky modul organizohet në disa fusha tematike që mbulojnë zhvillimin e të folurit në publik në mënyrë të plotë dhe të strukturuar. Fillimisht, nxënësit njihen me të folurit në publik si proces komunikimi dhe me dimensionin etik të tij.

Më pas, ata njihen me analizën e audiencës

dhe mësojnë të përshtatin mesazhin sipas dëgjuesit dhe kontekstit.
Në vijim, përqendrohen në përzgjedhjen e temës, përcaktimin e qëllimeve dhe hulumtimin, si dhe në organizimin dhe strukturimin e fjalimit ose prezantimit. Kjo shoqërohet me zhvillimin e stilit të të shprehurit, përdorimin e elementeve joverbale dhe të mjeteve mbështetëse.
Moduli përfshin gjithashtu punën me lloje të ndryshme fjalimesh ose prezantimesh, analizën e modeleve konkrete dhe zhvillimin e aftësive për të vlerësuar dhe vetëvlerësuar. Në përmbyllje, nxënësit realizojnë një fjalim të strukturuar si produkt final, duke zbatuar njohuritë dhe aftësitë e fituara.

1) Të folurit në publik dhe etika

Në këtë pjesë të modulit, nxënësit njihen me përkufizimin e të folurit në publik dhe, njëkohësisht, e kuptojnë atë si një proces komunikimi, ku ndërveprojnë qëllimi, mesazhi, audienca dhe konteksti. Duke u nisur nga përvoja të afërta për ta, si përgjigjet me gojë, prezantimet në klasë apo diskutimet, nxënësit reflektojnë mbi mënyrën si i ndërtojnë dhe i shprehin mendimet e tyre para të tjerëve. Kështu, të folurit në publik nuk shihet si një situatë e veçuar apo e vështirë, por si një formë më e ndërgjegjshme dhe e organizuar e komunikimit të përditshëm.
Në vijim, nxënësit kuptojnë se të folurit në publik nuk është thjesht "të flasësh para të tjerëve", por një aftësi që zhvillohet gradualisht dhe që kërkon organizim të mendimit, përgjegjësi në përdorimin e gjuhës dhe vetëdije për ndikimin që ka te dëgjuesi. Ata mësojnë se çdo fjalim apo prezantim ka një qëllim të caktuar, të informojë, të bindë, të përshkruajë etj., dhe se mënyra si ndërtohet mesazhi lidhet drejtpërdrejt me këtë qëllim dhe me audiencën.
Në këtë kontekst, trajtohen disa dimensione:

- ✓ *Të folurit në publik si proces komunikimi*: Nxënësit analizojnë elementet bazë të komunikimit (folësi, mesazhi, kanali, dëgjuesi, kodi), duke i lidhur ato me situata konkrete nga jeta e klasës. Përmes shembujve dhe diskutimeve, ata kuptojnë se suksesi i një prezantimi ose fjalimi nuk varet vetëm nga përmbajtja, por edhe nga mënyra si strukturohet dhe përcillet mesazhi.
- ✓ *Dallimi midis komunikimit publik dhe komunikimit të përditshëm*: Duke krahasuar situata të zakonshme komunikimi me ato të të folurit para një audience, nxënësit kuptojnë se komunikimi i përditshëm është më spontan dhe më pak i strukturuar, ndërsa të folurit në publik kërkon planifikim, organizim dhe qartësi më të madhe. Ata vërejnë gjithashtu se

në komunikimin publik kërkohet saktësi më e madhe gjuhësore dhe përzgjedhje më e kujdesshme e fjalorit.

Komunikimi i përditshëm	**Komunikimi publik**
Spontan, i lirë	I planifikuar
Pak i strukturuar	I organizuar qartë
Gjuhë më informale	Gjuhë e saktë dhe e kujdesshme
Fjalor i thjeshtë	Fjalor i përzgjedhur
Pa shumë përgatitje	Kërkon përgatitje paraprake
Reagim i menjëhershëm	Kontroll dhe menaxhim i reagimeve
Situata të përditshme	Situata formale

- ✓ *Dimensioni historik dhe kulturor i të folurit në publik:* Nxënësit njihen me rolin që ka luajtur fjala publike në zhvillimin e shoqërisë, nga retorika në antikitet deri te format e sotme të komunikimit mediatik. Kjo i ndihmon të kuptojnë se të folurit në publik është një mjet i rëndësishëm ndikimi dhe përgjegjësie në jetën shoqërore.

Etika e të folurit në publik trajtohet e lidhur ngushtë me situatat reale të komunikimit. Duke qenë se të folurit në publik është një formë pushteti, ai shoqërohet me përgjegjësi të qarta etike, që lidhen me mënyrën si ndërtohet dhe përcillet mesazhi.

Nxënësit analizojnë rëndësinë e sinqeritetit dhe të përgjegjësisë në komunikim, duke kuptuar se një folës etik nuk e shtrembëron të vërtetën për përfitime personale dhe synon gjithmonë të jetë i saktë dhe i besueshëm. Ata reflektojnë mbi shmangien e gjuhës fyese, diskriminuese apo manipuluese, duke vlerësuar ndikimin që ka përdorimi i gjuhës në dinjitetin e individëve dhe grupeve të ndryshme. Po ashtu, theksohet respektimi i audiencës dhe i mendimeve të ndryshme, si dhe përdorimi i një gjuhe të kujdesshme dhe gjithëpërfshirëse.

Në këtë kuadër, nxënësit mësojnë të vlerësojnë cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit, të shmangin keqinformimin dhe të mos humbasin kohën e audiencës me përmbajtje të pasakta ose të papërgatitura. Një vëmendje e veçantë i kushtohet shmangies së plagjiaturës në të gjitha format e saj, duke kuptuar se çdo fjalim ose prezantim duhet të përfaqësojë punën, mendimin dhe gjuhën e vetë folësit, si dhe duke respektuar rregullat e citimit dhe të përdorimit të burimeve.

Parimet etike nuk trajtohen si rregulla formale, por si udhëzime që duhen zbatuar në çdo situatë komunikimi. Në të njëjtën kohë, nxënësit ndërgjegjësohen për rolin e tyre edhe si dëgjues, duke zhvilluar aftësinë për të dëgjuar me vëmendje, për të shmangur paragjykimet dhe për të mbështetur shprehjen e lirë të ideve.

Në këtë mënyrë, etika kuptohet jo vetëm si normë morale, por edhe si kusht i rëndësishëm për një komunikim efektiv, të besueshëm dhe me ndikim.

2) Përzgjedhja e temës, qëllimeve dhe hulumtimi

Në këtë pjesë të modulit, nxënësit udhëzohen të përzgjedhin tema të përshtatshme dhe me rëndësi, duke u nisur nga interesat e tyre, përvoja personale dhe çështje aktuale që lidhen me jetën shoqërore, shkollore dhe temat ndërkurrikulare. Theksohet që tema të jetë e qartë dhe e fokusuar, pra të shmangen temat shumë të gjera ose të paqarta. Po ashtu, nxënësit orientohen të marrin në konsideratë audiencën: nivelin e njohurive, interesat dhe pritshmëritë e saj. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë se zgjedhja e temës nuk është vetëm çështje preference personale, por edhe përgjegjësi komunikimi.

Në vijim, nxënësit mësojnë të përcaktojnë qëllimin e fjalimit të tyre (informues, bindës, rrëfyes etj.) dhe të dallojnë ndikimin që ka secili qëllim në mënyrën e ndërtimit të mesazhit. Ata udhëzohen të formulojnë ide kryesore të qarta dhe të lidhura logjikisht, duke shmangur shpërndarjen e paorganizuar të informacionit. Për këtë qëllim, përdoren teknika të ndryshme organizimi, si harta e mendjes, stuhia e mendimit, skemat e ideve dhe listimi i çështjeve kryesore, të cilat ndihmojnë në strukturimin paraprak të fjalimit.

Pjesa e hulumtimit synon zhvillimin e aftësive kërkimore dhe mendimin kritik. Nxënësit orientohen të kërkojnë informacion nga burime të ndryshme dhe të besueshme, si libra, artikuj, faqe zyrtare dhe platforma edukative. Ata mësojnë të vlerësojnë cilësinë e burimit, duke marrë parasysh autorin, institucionin, kohën e publikimit dhe qëllimin e informacionit. Theksohet dallimi midis informacionit të verifikuar dhe atij të pasaktë, si dhe rëndësia e shmangies së keqinformimit.

Nxënësit ushtrohen në përzgjedhjen e informacionit më të rëndësishëm, duke shmangur mbingarkesën me të dhëna të panevojshme. Ata mësojnë të përdorin shembuj konkretë, fakte dhe statistika për të mbështetur idetë e tyre, si dhe të lidhin informacionin e gjetur me qëllimin e fjalimit dhe me audiencën.

Në një qasje bashkëkohore, nxënësit përdorin mjete digjitale për kërkim dhe organizim të informacionit, si motorë kërkimi, platforma edukative dhe aplikacione për strukturimin e ideve.

Ata njihen edhe me përdorimin e mjeteve të inteligjencës artificiale për gjenerimin e ideve fillestare, për përmirësimin e formulimit të qëllimit dhe për organizimin e përmbajtjes. Theksohet se këto mjete duhet të përdoren në mënyrë kritike dhe etike, duke verifikuar gjithmonë informacionin dhe duke shmangur përdorimin e përmbajtjeve të gatshme pa reflektim personal.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj tematike është ndërgjegjësimi për përdorimin e drejtë të burimeve. Nxënësit mësojnë të shmangin plagjiaturën në të gjitha format e saj dhe të përmendin burimet kur përdorin ide, citime apo të dhëna të marra nga të tjerët.

Në përfundim, nxënësit ndërtojnë një bazë të qëndrueshme për fjalimin e tyre, duke e mbështetur atë në një temë të zgjedhur mirë, në një qëllim të qartë dhe në informacion të saktë, të përzgjedhur dhe të organizuar në mënyrë logjike. Kjo fazë shërben si themel për zhvillimin e mëtejshëm të fjalimit ose të prezantimit.

3) Analiza e audiencës

Në këtë pjesë të modulit, nxënësit mësojnë se çdo prezantim ndërtohet në funksion të audiencës dhe se suksesi i komunikimit varet nga aftësia për ta kuptuar dhe për t'iu përshtatur dëgjuesit. Ata mësojnë të mbledhin dhe të analizojnë informacion mbi karakteristikat e audiencës, si mosha, interesat, niveli i njohurive, pritshmëritë dhe konteksti në të cilin zhvillohet komunikimi.

Nxënësit kuptojnë dallimet midis audiencave të ndryshme (p.sh., klasë, publik i gjerë, audiencë online) dhe mësojnë të përshtatin përmbajtjen, strukturën, gjuhën dhe stilin e fjalimit ose prezantimit sipas këtyre dallimeve. Ata punojnë për të ndërtuar mesazhe të qarta dhe të kuptueshme, për të zgjedhur tonin e duhur dhe për të përdorur strategji që rrisin përfshirjen dhe interesin e audiencës.

Në një qasje bashkëkohore, kjo temë përfshin edhe analizën e audiencës digjitale, ku nxënësit njihen me mënyrën si ndryshon komunikimi në platforma online (prezantime virtuale, video, podcast-e). Ata mësojnë:

- ✓ të përshtatin gjuhën dhe stilin për komunikim përpara kamerës;
- ✓ të strukturojnë mesazhe më të shkurtra dhe më të drejtpërdrejta për audienca online;
- ✓ të përdorin elemente ndërvepruese (pyetje, komente, sondazhe) për të mbajtur vëmendjen e audiencës.

Gjithashtu, nxënësit njihen me përdorimin e mjeteve digjitale për të kuptuar më mirë audiencën, si analiza e reagimeve (komente, pëlqime, sondazhe) dhe përshtatja e mesazhit në bazë të tyre. Në këtë mënyrë, ata zhvillojnë aftësinë për të qenë fleksibël dhe të vetëdijshëm gjatë komunikimit, duke reaguar në kohë reale ndaj audiencës dhe duke e bërë fjalimin ose prezantimin më efektiv dhe më ndikues.

4) Organizimi, struktura dhe stili

Gjatë kësaj pjese të modulit, nxënësit mësojnë të ndërtojnë fjalime të organizuara dhe të qarta, duke ndjekur strukturën bazë: hyrje me ndikim, zhvillim logjik dhe mbyllje të qëllimshme. Ata kuptojnë rolin e secilës pjesë të fjalimit dhe ushtrohen në përdorimin e teknikave të ndryshme për të tërhequr vëmendjen e audiencës që në fillim, për të zhvilluar idetë në mënyrë koherente dhe për ta përmbyllur fjalimin me një mesazh të fortë dhe të mbetur në mendje.
Nxënësit mësojnë të organizojnë idetë përmes skemave të ndryshme (p.sh. kronologjike, shkak-pasojë, problem-zgjidhje), si dhe të përdorin teknika si rrëfimi, shembujt konkretë, statistikat dhe argumentet për të mbështetur mesazhin e tyre. Ata zhvillojnë aftësinë për të krijuar lidhje të qarta midis ideve dhe për të ruajtur vijueshmërinë gjatë gjithë fjalimit.
Në këtë kuadër, punohet edhe mbi gjuhën dhe stilin e të folurit, ku nxënësit mësojnë të:

- ✓ përdorin një gjuhë të qartë, të saktë dhe të përshtatshme për audiencën;
- ✓ respektojnë rregullat e gramatikës dhe të shqiptimit;
- ✓ përdorin mjete stilistike për ta bërë fjalimin më shprehës dhe më bindës;
- ✓ zbatojnë parimet e gjuhës gjithëpërfshirëse dhe të komunikimit etik.

Në një qasje bashkëkohore, kjo pjesë përfshin edhe mënyrën e strukturimit të përmbajtjes për mjedise digjitale, ku nxënësit mësojnë:

- ✓ të organizojnë mesazhe më të shkurtra dhe më të drejtpërdrejta për prezantime online ose video;
- ✓ të ndërtojnë fjalime që funksionojnë si për audienca fizike, ashtu edhe për ato virtuale;
- ✓ të përdorin mjete digjitale për organizimin e ideve (aplikacione për hartëzim konceptual, skema dhe prezantime).

Gjithashtu, nxënësit njihen me përdorimin e mjeteve me inteligjencë artificiale për të përmirësuar strukturën dhe stilin e fjalimit (p.sh., për riformulimin e ideve, kontrollin e qartësisë dhe organizimit), duke u udhëzuar të përdorin këto mjete në mënyrë të ndërgjegjshme dhe kritike.

Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të ndërtuar fjalime të strukturuara mirë, me gjuhë të përshtatshme dhe stil të qëllimshëm, të afta për të komunikuar qartë dhe për të ndikuar audiencën në kontekste të ndryshme.

5) Komunikimi joverbal

Në këtë pjesë të modulit, theksi vendoset te komunikimi joverbal, si një element i rëndësishëm i të folurit në publik. Nxënësit mësojnë të përdorin në mënyrë të vetëdijshme:

- ✓ gjestet dhe lëvizjet e trupit;
- ✓ qëndrimin dhe pozicionimin në hapësirë;
- ✓ kontaktin me sy dhe shprehjet e duhura të fytyrës;

për të përforcuar mesazhin dhe për të krijuar lidhje me audiencën.

Gjithashtu, ata zhvillojnë aftësi për të menaxhuar kohën dhe ritmin e të folurit, duke përdorur pauzat për theksim dhe për të rritur kuptueshmërinë e fjalimit.

Nxënësit praktikojnë mënyra për të reaguar në situata reale komunikimi, si përgjigjja ndaj pyetjeve, përballimi i ndërprerjeve apo ruajtja e qetësisë gjatë prezantimit.

Në një qasje bashkëkohore, kjo temë përfshin edhe komunikimin joverbal në mjedise digjitale, ku nxënësit mësojnë:

- ✓ të përshtatin gjestet dhe mimikën për komunikim para kamerës;
- ✓ të përdorin kontaktin vizual përmes kamerës dhe pozicionimin e duhur në ekran;
- ✓ të menaxhojnë zërin, ritmin dhe praninë gjatë prezantimeve online;

Në këtë mënyrë, nxënësit fitojnë siguri si folës, si në mjedise fizike, ashtu edhe në ato virtuale.

6) Menaxhimi i ankthit dhe i emocioneve

Në këtë pjesë të modulit, nxënësit njihen me rolin e emocioneve në të folurit në publik dhe kuptojnë se ndjesi si ankthi, nervozizmi apo pasiguria janë të zakonshme dhe të natyrshme gjatë prezantimit. Ata mësojnë të dallojnë shenjat fizike dhe psikologjike të ankthit, si rrahjet e shpejta të zemrës, tensioni, vështirësitë në të shprehur apo humbja e përqendrimit, duke i parë këto jo si pengesa, por si pjesë të procesit të komunikimit.
Nxënësit orientohen të kuptojnë se ankthi mund të menaxhohet dhe, në disa raste, mund të shfrytëzohet si energji pozitive për të përmirësuar performancën. Në këtë kuadër, ata ushtrohen në përdorimin e teknikave të thjeshta dhe praktike për kontrollin e emocioneve, si:

- ✓ frymëmarrja e thellë dhe e rregullt për qetësimin e trupit;
- ✓ përgatitja paraprake dhe njohja e mirë e materialit;
- ✓ përsëritja dhe praktika e vazhdueshme për rritjen e sigurisë;
- ✓ vizualizimi i një prezantimi të suksesshëm;
- ✓ përqendrimi te mesazhi dhe jo te frika nga gabimi.

Gjithashtu, nxënësit mësojnë strategji për menaxhimin e situatave të papritura gjatë prezantimit, si harrimi i një pjese të fjalimit, ndërprerjet apo reagimet e audiencës. Ata ushtrohen të ruajnë qetësinë, të rimarrin veten dhe të vazhdojnë komunikimin pa e humbur rrjedhën e mesazhit.
Në këtë proces, theksohet rëndësia e vetëbesimit dhe e qëndrimit pozitiv ndaj vetes. Nxënësit zhvillojnë aftësinë për të reflektuar mbi performancën e tyre, duke identifikuar pikat e forta dhe ato që duhen përmirësuar, pa u fokusuar vetëm te gabimet. Ata kuptojnë se përmirësimi vjen përmes praktikës dhe përvojës së vazhdueshme.
Në një qasje bashkëkohore, trajtohet edhe menaxhimi i emocioneve në mjedise digjitale, ku nxënësit mësojnë të përballojnë ndjesi të ngjashme gjatë prezantimeve online, regjistrimeve video apo komunikimit përmes platformave virtuale. Ata udhëzohen të ruajnë qartësinë, ritmin dhe sigurinë në të folur, edhe në mungesë të reagimit të drejtpërdrejtë të audiencës.
Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të menaxhuar emocionet e tyre gjatë të folurit në publik, si në mjedise fizike, ashtu edhe në ato digjitale.

7) Mjetet pamore dhe teknologjitë digjitale

Nxënësit mësojnë të përdorin mjete pamore dhe digjitale për të përforcuar dhe për të qartësuar mesazhin e të folurit në publik, duke e bërë atë më të kuptueshëm dhe më tërheqës për audiencën. Ata ushtrohen në hartimin e prezantimeve me slide, duke përfshirë grafikë, tabela, imazhe dhe elemente të tjera vizuale që mbështesin idetë kryesore.

Në vijim, ata njihen edhe me përdorimin e platformave të komunikimit virtual dhe me mënyrën e përshtatjes së prezantimit në mjedise online. Kjo përfshin organizimin e përmbajtjes në mënyrë të përmbledhur dhe vizuale, si dhe shmangien e mbingarkesës me informacion.

Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të kombinuar të folurin me elemente pamore dhe digjitale, duke e bërë komunikimin më efektiv në situata të ndryshme reale, si në prezantime në klasë, ashtu edhe në mjedise virtuale.

Moduli prezanton edhe mundësitë që ofrojnë teknologjitë e reja për zhvillimin e aftësive të të folurit në publik. Nxënësit njihen me përdorimin e simulimeve virtuale për praktikimin e prezantimeve në situata të ndryshme dhe me mjete që ofrojnë feedback të drejtpërdrejtë për përmirësimin e performancës së tyre. Po ashtu, ata njihen me përdorimin e aplikacioneve për përmirësimin e qartësisë së gjuhës, menaxhimin e ritmit të të folurit dhe organizimin e përmbajtjes, si dhe me mjete që ndihmojnë në përshtatjen e komunikimit për audienca të ndryshme.

Në të gjitha rastet, theksohet përdorimi i ndërgjegjshëm dhe kritik i këtyre teknologjive, si mjete mbështetëse për përmirësimin e komunikimit dhe jo si zëvendësim i punës dhe përgatitjes personale.

8) Llojet e fjalimeve dhe vlerësimi

Nxënësit njohin dhe punojnë me lloje të ndryshme fjalimesh, si informuese, bindëse dhe për raste të veçanta, si p.sh.:

- ✓ *Fjalimi informues*: Nxënësi informon për një temë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
  Shembull: një fjalim për sigurinë në internet, për shëndetin mendor ose për ndikimin e teknologjisë në jetën e përditshme.
- ✓ *Fjalimi bindës*: Nxënësi mbron një ide dhe përpiqet të ndikojë te audienca.
  Shembuj: Pse duhet të mbrojmë mjedisin? Pse të rinjtë duhet të përfshihen në komunitet? Pse duhet të përdoret teknologjia në mënyrë të përgjegjshme?
- ✓ *Fjalimi për raste të veçanta:* Nxënësi përgatit një fjalim për një situatë konkrete.
  Shembuj: një fjalim për 28 Nëntorin, një mesazh për një aktivitet shkollor ose një falënderim.

Për t'i kuptuar më mirë këto lloje, nxënësit njihen edhe me modele reale të të folurit në publik, si ligjërimet e Demostenit dhe Ciceronit nga antikiteti; fjalimet historike shqiptare si ato të Ismail Qemalit, fjalimi i Martin Luther King "Unë kam një ëndërr"; fjalimet publike të Ismail Kadaresë apo fjalimet e nxënësve në aktivitete si Parlamenti i Nxënësve, ku trajtohen çështje që lidhen drejtpërdrejt me të rinjtë dhe shoqërinë.

Gjatë punës, nxënësit analizojnë këto modele për të kuptuar si ndërtohet një fjalim ose prezantim i suksesshëm dhe si përdoren argumentet dhe emocionet për të ndikuar audiencën.

Nxënësit mësojnë gjithashtu të vlerësojnë fjalimet e tyre dhe të shokëve, duke dhënë komente të qarta dhe ndihmuese, të mbështetura në kritere si qartësia e mesazhit, organizimi i ideve, mënyra e prezantimit dhe përdorimi i gjuhës.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë disa fjalime (botërore dhe shqiptare), të cilat mund të përzgjidhen gjatë zhvillimit të modulit.

Nr.	Titulli i fjalimit	Folësi	Viti
1	Kam një ëndërr (I Have a Dream)	Martin Luther King Jr.	1963
2	Fjalimi i Gettysburgut	Abraham Lincoln	1863
3	Do të luftojmë në plazhe	Winston Churchill	1940
4	Fjalimi inaugurues (Mos pyet…)	John F. Kennedy	1961
5	Fjalimi inaugurues (Frika vetë)	Franklin D. Roosevelt	1933
6	Takimi me fatin	Jawaharlal Nehru	1947
7	Shembeni këtë mur!	Ronald Reagan	1987
8	Jam gati të vdes	Nelson Mandela	1964
9	Fjalimi në Tilbury	Elizabeth I	1588
10	Më jepni liri ose vdekje!	Patrick Henry	1775
11	Ich bin ein Berliner	John F. Kennedy	1963
12	A nuk jam unë një grua?	Sojourner Truth	1851
13	Lini Indinë (Vepro ose vdis)	Mahatma Gandhi	1942
14	Fjalimi i dorëzimit të Japonisë	Hirohito	1945
15	Fjalimi për Çmimin "Nobel për Paqen"	Malala Yousafzai	2014

Nr.	Titulli / rasti i fjalimit	Folësi	Viti
1	Fjalimi i Shpalljes së Pavarësisë	Ismail Qemali	1912
2	Fjalime politike dhe parlamentare	Fan Noli	1920–1924
3	Ligjërime atdhetare dhe kulturore	Gjergj Fishta	fillim shek. XX
5	Fjalime politike në periudhën moderne	Ibrahim Rugova	1990–2000
6	Fjalimi i Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës	Hashim Thaçi	2008
7	Fjalime publike dhe kulturore	Ismail Kadare	vite të ndryshme
8	Fjalime në Parlamentin e Nxënësve	Nxënës shqiptarë	vite të ndryshme

9) Produkti final

Në përmbyllje, çdo nxënës përgatit dhe prezanton një fjalim të strukturuar mbi një temë ndërkurrikulare, duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë modulit.
Tema e fjalimit mund të përzgjidhet nga një prej çështjeve të mëposhtme:

- ✓ Ruajtja e gjuhës, kulturës dhe traditave në një shoqëri bashkëkohore (identiteti kombëtar).
- ✓ Roli i të rinjve në komunitet dhe nisma për zgjidhjen e problemeve (qytetaria aktive dhe sipërmarrja).
- ✓ Mirëqenia, stili i jetesës dhe siguria në jetën reale dhe digjitale (shëndeti mendor e fizik dhe siguria).
- ✓ Mbrojtja e mjedisit dhe përdorimi i përgjegjshëm i burimeve (zhvillimi i qëndrueshëm).
- ✓ Ndikimi i teknologjisë dhe i mediave në jetën tonë (teknologjia, shoqëria dhe media).

Nxënësi:

- ✓ përzgjedh temën dhe përcakton qëllimin e fjalimit;
- ✓ hulumton dhe përzgjedh informacion të besueshëm;
- ✓ organizon idetë në mënyrë të qartë dhe të strukturuar;
- ✓ përgatit dhe prezanton fjalimin përpara një audience reale ose në një format digjital.

Gjatë prezantimit, nxënësi përdor argumente, shembuj dhe mjete mbështetëse për ta bërë fjalimin të qartë dhe bindës, si dhe përshtat mënyrën e të folurit sipas audiencës.
Produkti final shërben si një demonstrim konkret i aftësive të fituara në të folurin në publik dhe si një mundësi për të shprehur qëndrime mbi çështje që lidhen me jetën dhe shoqërinë.

4. KLASAT KU MUND TË ZHVILLOHET MODULI "TË FOLURIT NË PUBLIK"

Ky modul mund të zhvillohet në klasën X ose XI ose XII të arsimit të mesëm të lartë, duke u përshtatur me nevojat, interesat dhe nivelin e nxënësve. Zbatimi i tij në secilën prej këtyre klasave është i arsyetuar, pasi të folurit në publik është një aftësi që lidhet me zhvillimin e mendimit kritik, krijimtarisë dhe ndërveprimit, si dhe që është e nevojshme në çdo klasë të arsimit të mesëm të lartë.

Në këtë mënyrë, moduli mund të zbatohet me fleksibilitet nga mësuesi, duke e përshtatur me kontekstin e klasës dhe ritmin e të nxënit të nxënësve.

5. MËSUESIT QË MUND TË ZHVILLOJNË MODULIN "TË FOLURIT NË PUBLIK"

Moduli mund të zhvillohet nga:

- ✓ mësues të gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- ✓ mësues të gjuhëve të huaja;
- ✓ mësues të arteve;
- ✓ mësues të lëndëve sociale.

Mësuesit që e zhvillojnë këtë modul:

- ✓ duhet të kenë prirje për të folurit në publik dhe komunikimin efektiv;
- ✓ duhet të nxisin dhe praktikojnë dëgjimin aktiv në klasë;
- ✓ duhet të zotërojnë njohuri bazë për strukturimin e të folurit në publik dhe teknikat e prezantimit;
- ✓ duhet të përdorin mjete digjitale për mbështetjen e komunikimit dhe të prezantimit.

6. KOHËZGJATJA E MODULIT "TË FOLURIT NË PUBLIK"

Në klasat X dhe XI, moduli mund të zhvillohet në rreth *36 orë mësimore*, ndërsa në klasën XII në *34 orë mësimore*, duke marrë parasysh ngarkesën dhe specifikat e kësaj klase.
Në të dyja rastet, *përmbajtja e modulit mbetet e njëjtë,* ndërsa ndryshon vetëm mënyra e trajtimit të saj, përmes përshtatjes së nivelit të vështirësisë dhe llojit të aktiviteteve. Kjo i jep mësuesit fleksibilitet për ta zbatuar modulin në mënyrë efektive, duke e përshtatur me karakteristikat dhe ritmin e të nxënit të nxënësve.

- ✓ Nëse moduli zhvillohet në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle, ai nuk vlerësohet me notë, por vetëm për përfundimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve.
- ✓ Nëse moduli zhvillohet në kuadër të kurrikulës me zgjedhje, ai vlerësohet me notë, sipas të njëjtave procedura dhe kritere si në lëndët ose modulet e tjera. Shënim: Në fund të periudhave, vlerësimi nuk realizohet me teste, por me detyra përmbledhëse, të cilat pasqyrojnë njohuritë dhe aftësitë e nxënësve.

7. REZULTATET E TË NXËNIT

Gjatë zhvillimit të modulit "Të folurit në publik", nxënësi:

- ✓ vlerëson rëndësinë e të folurit në publik, duke përshkruar rolin e tij në jetën personale, akademike dhe profesionale, si dhe duke analizuar ndikimin e tij në mjedise fizike dhe digjitale;
- ✓ analizon dhe përshtat komunikimin sipas audiencës, duke identifikuar karakteristikat e dëgjuesve (fizikë dhe virtualë) dhe duke zgjedhur strategjitë e duhura për t'u lidhur me ta;
- ✓ zbaton aftësitë e të dëgjuarit aktiv, duke identifikuar idetë kryesore, duke mbajtur shënime dhe duke dhënë sugjerime të përshtatshme (feedback);
- ✓ përzgjedh dhe formulon temën, qëllimet dhe idetë kryesore të një fjalimi, duke përdorur teknika si stuhi mendimi dhe duke ndërtuar mesazhe të qarta dhe të strukturuara;
- ✓ zbaton procesin e kërkimit për përgatitjen e një fjalimi, duke përdorur burime të besueshme, mjete digjitale dhe duke përzgjedhur materiale mbështetëse të përshtatshme;
- ✓ organizon dhe strukturon një fjalim ose një prezantim, duke ndërtuar hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin në mënyrë koherente dhe të qëllimshme;

- ✓ përdor gjuhë dhe stil të përshtatshëm gjatë të folurit në publik, duke respektuar rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore, duke përdorur mjete stilistike dhe duke zbatuar etikën e komunikimit;
- ✓ zbaton teknika efektive të prezantimit, duke përdorur komunikimin joverbal (gjeste, kontakt me sy, qëndrim) dhe duke menaxhuar kohën dhe hapësirën gjatë prezantimit;
- ✓ përdor mjete digjitale dhe pamore në prezantim, duke integruar platforma prezantimi, video, grafikë dhe elemente multimediale për të përforcuar mesazhin;
- ✓ dallon dhe përdor lloje të ndryshme të fjalimeve, duke hartuar dhe prezantuar fjalime informuese, bindëse dhe për raste të veçanta në kontekste reale dhe digjitale;
- ✓ përdor mjete bashkëkohore për përmirësimin e të folurit në publik, duke shfrytëzuar teknologji si inteligjenca artificiale për feedback dhe platforma digjitale për praktikë dhe reflektim;
- ✓ reflekton dhe vlerëson performancën e vet dhe të të tjerëve, duke identifikuar pikat e forta dhe fushat për përmirësim dhe duke përdorur feedback për zhvillim të mëtejshëm;
- ✓ zhvillon dhe prezanton një fjalim mbi një temë ndërkurrikulare, si identiteti kombëtar, qytetaria aktive dhe sipërmarrja, shëndeti mendor e fizik dhe siguria, zhvillimi i qëndrueshëm ose teknologjia, shoqëria dhe media, duke integruar kërkimin, strukturimin e ideve dhe teknikat e prezantimit;
- ✓ argumenton dhe mbron qëndrimin e tij mbi një çështje ndërkurrikulare, duke përdorur evidenca, shembuj dhe teknika bindëse në mënyrë të qartë, të strukturuar dhe etike për të ndikuar audiencën.

8. VEPRIMTARI PRAKTIKE PËR ZHVILLIMIN E MODULIT "TË FOLURIT NË PUBLIK"

Më poshtë janë përshkruar disa veprimtari sugjeruese praktike, të cilat janë grupuar sipas tematikave të modulit. Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin disa prej tyre, t'i përshtatin sipas nevojave të klasës ose të planifikojnë veprimtari të reja, në funksion të përmbushjes së rezultateve të pritshme të modulit.

Tematika 1: Të folurit në publik dhe etika

1) "Çfarë nuk shkon?"

Mësuesi paraqet 2-3 situata konkrete komunikimi (mund të jenë video të shkurtra, postime nga rrjete sociale ose tekste të shkruara), ku ka probleme të dukshme në mënyrën e komunikimit (mungesë qartësie, gjuhë e papërshtatshme, manipulim, informacion i pasaktë).
Nxënësit punojnë fillimisht individualisht dhe më pas në grupe, duke analizuar rastet sipas disa kritereve të qarta:

- ✓ Sa i kuptueshëm dhe i strukturuar është mesazhi?
- ✓ Çfarë qëndrimi mban folësi ndaj audiencës?
- ✓ A ka elemente të komunikimit jo etik (fyerje, paragjykim, ekzagjerim, manipulim, mungesë burimesh)?
- ✓ Çfarë ndikimi mund të ketë ky komunikim te dëgjuesit?

Çdo grup paraqet analizën e vet dhe propozon një version të përmirësuar të mesazhit. Diskutimi në klasë përqendrohet te fakti që komunikimi publik nuk është thjesht shprehje mendimi, por veprim me pasoja te të tjerët.

2) "Nga problematik në të besueshëm"

Nxënësve u jepen shembuj konkretë komunikimi me probleme etike, si:

- ✓ një koment publik me gjuhë fyese;
- ✓ një tekst me informacion të pasaktë;
- ✓ një fragment i kopjuar pa burim;
- ✓ një deklaratë që manipulon emocionet e audiencës.

Në grupe, nxënësit kanë për detyrë *ta riformulojnë mesazhin*:

- ✓ duke ruajtur idenë kryesore;
- ✓ duke përmirësuar qartësinë dhe strukturën;
- ✓ duke shmangur elementet jo etike;
- ✓ duke përdorur gjuhë të kujdesshme dhe të respektueshme.

Grupet prezantojnë variantet e tyre dhe argumentojnë zgjedhjet që kanë bërë. Klasa diskuton se cili variant është më i besueshëm dhe pse.

3) "Prezantim me përgjegjësi"

Nxënësit përgatitin një prezantim të shkurtër mbi një temë që e njohin dhe që u intereson (nga përvoja personale, shkolla, rrjetet sociale etj.). Kushti kryesor është që prezantimi të hartohet duke respektuar parime etike:

- ✓ të mos përmbajë informacion të pasaktë;
- ✓ të shmangë gjuhën fyese ose paragjykuese;
- ✓ të jetë i qartë;
- ✓ të tregojë respekt ndaj audiencës.

Gjatë prezantimit, pjesa tjetër e klasës evidenton:

- ✓ elemente pozitive në komunikim;
- ✓ momente ku mund të përmirësohet etika ose qartësia;
- ✓ ndikimin që pati fjalimi te dëgjuesit.

Vlerësimi jepet me argumente që evidentojnë anët pozitive dhe ato për përmirësim.

4) "Gjykata e komunikimit etik"

Mësuesi paraqet një rast konkret problematik (p.sh., një person që ka përdorur plagjiaturë në një prezantim, një deklaratë publike me gjuhë diskriminuese, një mesazh manipulues).
Nxënësit ndahen në role:

- ✓ folësi;
- ✓ audienca;
- ✓ vëzhguesit;
- ✓ "gjykata" (grup që jep vendimin).

Secili grup analizon rastin nga këndvështrimi i vet dhe në fund "gjykata" vendos:

- ✓ nëse komunikimi është etik apo jo;
- ✓ cilat parime janë shkelur;
- ✓ si mund të ishte formuluar mesazhi në mënyrë të drejtë dhe të përgjegjshme.

Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë etikën si praktikë konkrete, jo si rregull teorik.

5) "Identifikimi i plagjiaturës dhe përdorimi i burimeve"

Nxënësve u jepen disa fragmente tekstesh ose prezantimesh, ku përfshihen:

- ✓ një tekst origjinal;
- ✓ një tekst i kopjuar plotësisht;
- ✓ një tekst me citim të saktë.

Detyra e tyre është të dallojnë llojet e përdorimit të burimeve dhe të shpjegojnë pse disa prej tyre janë problematike. Në vijim, ata ushtrohen duke marrë një informacion të shkurtër dhe duke e përfshirë në një mesazh të tyre, si dhe duke treguar burimet në mënyrë të saktë.

6) "Reflektim mbi rolin si folës dhe dëgjues"

Në fund të trajtimit të kësaj tematike, nxënësit zhvillojnë një reflektim me shkrim ose me gojë, duke u ndalur te pyetjet e mëposhtme:

- ✓ Si ka ndryshuar mënyra e tyre e të folurit para të tjerëve?
- ✓ Çfarë do të thotë për ta një komunikim i ndershëm dhe i përgjegjshëm?
- ✓ Si mund të jenë dëgjues më të vëmendshëm?
- ✓ Çfarë do të përmirësonin në komunikimin e tyre në situata reale?

Tematika 2: Përzgjedhja e temës, qëllimit dhe hulumtimi

1) "Tregu i temave"

Mësuesi organizon klasën si një "treg idesh". Në tabelë vendosen kategori temash (shkolla, teknologjia, shëndeti, mjedisi, rrjetet sociale, shoqëria etj.).
Nxënësit:

- ✓ propozojnë tema konkrete brenda kategorive;
- ✓ diskutojnë në grupe nëse temat janë të qarta dhe të përshtatshme për audiencën;
- ✓ përmirësojnë temat shumë të gjera (p.sh.: teknologjia) duke i bërë më të fokusuara (si p.sh.: ndikimi i rrjeteve sociale te rezultatet e nxënësve).

Në fund, çdo nxënës "zgjedh" temën e vet dhe e prezanton përpara klasës:

- ✓ Pse është e rëndësishme?
- ✓ Për kë është e përshtatshme?
- ✓ Çfarë synon të komunikojë?

2) "Gjuetia e qëllimit"

Nxënësve u jepen disa mesazhe/fjalime të shkurtra. Ata duhet:

- ✓ të identifikojnë qëllimin (informues, bindës);
- ✓ të argumentojnë zgjedhjen e tyre;
- ✓ të propozojnë si do të ndryshonte mesazhi nëse qëllimi do të ishte ndryshe.

Në vijim, secili nxënës formulon qëllimin e fjalimit të vet në një fjali të qartë dhe e diskuton në grup, ku të tjerët japin sugjerime për përmirësim.

3) "Arkitektët e ideve"

Nxënësit punojnë në grupe dhe marrin një temë të njëjtë. Çdo grup duhet të ndërtojë një strukturë të ndryshme të mesazhit:

- ✓ një grup me hartën e mendjes;
- ✓ një grup me një listë çështjesh kryesore;
- ✓ një grup me skemë hyrje-zhvillim-përfundim/mbyllje.

Grupet prezantojnë mënyrën e tyre të organizimit dhe diskutojnë:

- ✓ Cila strukturë është më e qartë?

4) "Sfida e burimeve"

Mësuesi u jep nxënësve disa burime të ndryshme për të njëjtën temë (artikuj, faqe interneti, postime).
Nxënësit:

- ✓ vlerësojnë besueshmërinë e secilit burim (autor, të dhëna, qëllim);
- ✓ dallojnë informacion të saktë dhe të pasaktë;
- ✓ dallojnë faktet dhe opinionet;
- ✓ zgjedhin burimet më të vlefshme dhe të argumentojnë pse janë të tilla.

Në fund, ata krijojnë një listë të shkurtër burimesh që mund të përdornin për fjalimin ose prezantimin e tyre.

5) "Përfshirja e argumenteve"

Çdo nxënës merr informacion të shkurtër (fakte, statistika, shembuj) dhe ka për detyrë ta shndërrojë atë në argumente të qarta.
Pastaj:

- ✓ nxënësi prezanton argumentet në 60- 90 sekonda;
- ✓ klasa vlerëson nëse argumentet janë të kuptueshme;
- ✓ klasa sugjeron mënyra për t'i përforcuar (më shumë shembuj, më shumë qartësi, lidhje më e mirë me qëllimin etj.).

6) "Plagjiaturë apo jo?"

Nxënësve u jepen disa shembuj përdorimi informacioni:

- ✓ kopjim i plotë;
- ✓ riformulim pa burim;
- ✓ përdorim i saktë me citim;

Në grupe, ata vendosin:

- ✓ Cilat janë të pranueshme dhe cilat jo?
- ✓ Pse janë problematike disa raste?
- ✓ Si duhet të korrigjohen?

Në vijim, nxënësit praktikojnë përfshirjen e një burimi në mesazhin e tyre në mënyrë të saktë dhe të thjeshtë.

7) "IA si ndihmëse, jo zëvendësuese"

Nxënësit përdorin Inteligjencën Artificiale për të gjeneruar ide për temën e tyre. Më pas:

- ✓ krahasojnë idetë e gjeneruara me idetë e tyre;
- ✓ zgjedhin vetëm ato që kanë kuptim dhe i përpunojnë;
- ✓ reflektojnë se çfarë ishte e dobishme dhe çfarë jo.

Diskutimi përqendrohet te përdorimi kritik dhe etik i teknologjisë.

8) "Provë në një minutë"

Çdo nxënës prezanton për një minutë:

- ✓ temën;
- ✓ qëllimin;
- ✓ dy-tri ide kryesore;
- ✓ një burim që do të përdorë.

Klasa dhe mësuesi japin vlerësime dhe komente mbi:

- ✓ qartësinë e temës;
- ✓ përshtatjen me audiencën;
- ✓ qartësinë e ideve dhe të burimeve.

Nxënësit përmirësojnë idenë e tyre bazuar në këto komente.

Tematika 3: Analiza e audiencës

1) "Kush është audienca ime?"

Mësuesi paraqet disa skenarë komunikimi (p.sh., prezantim në klasë, fjalim për prindërit e shkollës, video për rrjete sociale).
Nxënësit, në grupe, ndërtojnë një *profil të audiencës* për secilin skenar duke përcaktuar:

- ✓ moshën dhe njohuritë (pak ose shumë);
- ✓ interesat dhe pritshmëritë;
- ✓ qëndrimin ndaj temës (neutral, kritik, i interesuar);
- ✓ kontekstin (formal, informal, online).

Çdo grup prezanton profilin dhe argumenton si ndikon kjo në mënyrën e komunikimit. Diskutimi përqendrohet te ideja që i njëjti mesazh nuk funksionon njësoj për çdo audiencë.

2) "I njëjti mesazh, tri audienca"

Nxënësit marrin një temë të përbashkët (p.sh., përdorimi i uniformës në shkollë). Detyra e tyre është të hartojnë *tri versione të ndryshme të të njëjtit mesazh*:

- ✓ për bashkëmoshatarët;
- ✓ për mësuesit/prindërit;
- ✓ për një audiencë online.

Ata duhet të ndryshojnë:

- ✓ gjuhën (formale/informale);
- ✓ strukturën (më e detajuar / më e përmbledhur);
- ✓ tonin dhe shembujt.

Në fund, prezantojnë variantet dhe klasa diskuton:

- ✓ Cili është më i përshtatshëm për secilën audiencë?
- ✓ Çfarë ndryshimesh e bëjnë mesazhin më efektiv?

3) "Transformo prezantimin"

Nxënësit marrin një prezantim të shkurtër të shkruar për klasën dhe duhet ta *transformojnë për një audiencë online* (video ose postim).
Ata:

- ✓ duhet të shkurtojnë mesazhin;
- ✓ duhet të përdorin fjali më të drejtpërdrejta;
- ✓ duhet të shtojnë elemente që mbajnë vëmendjen (pyetje, thirrje për reagim).

Grupet prezantojnë versionin fillestar dhe atë të transformuar, duke shpjeguar ndryshimet që kanë bërë.

4) "Lexo audiencën"

Një nxënës prezanton një ide të shkurtër, ndërsa pjesa tjetër e klasës luan role të ndryshme audiencash:

- ✓ e interesuar;
- ✓ e shpërqendruar;
- ✓ kritike;
- ✓ pasive.

Folësi duhet të vërejë reagimet dhe të përshtatë komunikimin në kohë reale (të ndryshojë tonin, të shtojë shembuj, të bëjë pyetje).
Në fund, klasa diskuton:

- ✓ Cilat strategji funksionuan?
- ✓ Si ndikoi reagimi i audiencës në mënyrën e të folurit?

5) "Angazho audiencën"

Nxënësit punojnë në grupe dhe kanë për detyrë të krijojnë mënyra konkrete për të përfshirë audiencën gjatë një prezantimi:

- ✓ pyetje të hapura;
- ✓ mini-sondazhe;
- ✓ shembuj nga jeta reale;
- ✓ thirrje për reagim.

Çdo grup demonstron strategjitë e veta në një prezantim të shkurtër. Klasa vlerëson cilat teknika e mbajnë më shumë vëmendjen e të tjerëve dhe pse.

6) "Analizo audiencën digjitale"

Mësuesi paraqet shembuj reagimesh nga një platformë online (komente, pëlqime, shpërndarje). Nxënësit:

- ✓ interpretojnë reagimet (pozitive, negative, neutrale);
- ✓ nxjerrin përfundime për audiencën;
- ✓ propozojnë si duhet të përshtatet mesazhi në vazhdim.

Diskutimi përqendrohet te fakti që komunikimi online kërkon vëmendje të vazhdueshme ndaj reagimeve të audiencës.

7) "Prezantim me audiencë të përcaktuar"

Çdo nxënës përgatit një prezantim shumë të shkurtër (1 minutë), por me një audiencë të përcaktuar qartë (p.sh. nxënës të vegjël, prindër, publik online).
Nxënësi tregon:

- ✓ Si e ka përshtatur gjuhën dhe tonin?
- ✓ Pse ka zgjedhur këtë mënyrë komunikimi?

Klasa komenton nëse mesazhi ishte realisht i përshtatur për audiencën e synuar.

8) Reflektim: "Çfarë ndryshoj kur ndryshon audienca?"

Në fund të kësaj tematike, nxënësit reflektojnë me shkrim ose diskutim:

- ✓ Çfarë marrin parasysh tani përpara se të flasin?
- ✓ Si ndryshon mënyra e tyre e të shprehurit sipas audiencës?
- ✓ Cilat janë vështirësitë më të mëdha në përshtatjen e mesazhit?

Tematika 4: Organizimi, struktura dhe stili

1) "Hyrja interesante"

Mësuesi paraqet disa mënyra të ndryshme hyrjeje (pyetje, histori e shkurtër, fakt befasues, citim, situatë problemore).
Nxënësit:

- ✓ analizojnë efektin e secilës hyrje te audienca;
- ✓ diskutojnë pse disa janë më tërheqëse se të tjerat;
- ✓ krijojnë 2-3 hyrje të ndryshme për të njëjtën temë.

Në fund, prezantojnë hyrjet dhe klasa voton më interesanten, duke argumentuar zgjedhjen. Diskutimi përqendrohet edhe te lidhja midis hyrjes dhe qëllimit të fjalimit.

2) "Ndërto trupin e fjalimit"

Nxënësit ndahen në grupe dhe marrin të njëjtën temë, por secili grup duhet ta organizojë zhvillimin sipas një skeme të ndryshme:

- ✓ kronologjike;
- ✓ shkak-pasojë;
- ✓ problem-zgjidhje.

Grupet ndërtojnë një skemë të qartë të ideve dhe e prezantojnë. Klasa diskuton:

- ✓ Cila strukturë është më e kuptueshme?
- ✓ Në cilat raste përdoret secila?
- ✓ Si ndikon struktura në forcën e mesazhit?

3) "Koherenca në fjalim ose prezantim"

Nxënësve u jepet një fjalim i shkurtër i çrregullt (pa lidhje logjike midis pjesëve).
Detyra e tyre është:

- ✓ të riorganizojnë rendin e ideve;
- ✓ të shtojnë lidhëza dhe kalime midis paragrafëve;
- ✓ të krijojnë një rrjedhë të qartë nga hyrja te përfundimi.

Në fund, krahasohen versionet dhe diskutohet si ndikon koherenca në kuptueshmërinë e mesazhit.

4) "Mbyllje që mbetet në mendje"

Nxënësit analizojnë disa përfundime fjalimesh (të dobëta dhe të forta).
Më pas, çdo nxënës:

- ✓ krijon një përfundim për temën e vet;
- ✓ përpiqet të përfshijë një element ndikues (thirrje për veprim, përmbledhje e fortë, mesazh emocional).

Klasa diskuton se cilat përfundime janë më të suksesshme dhe pse.

5) "Stili bën diferencën"

Nxënësve u jepet një tekst i thatë. Në grupe, ata duhet ta përmirësojnë:

- ✓ duke përdorur gjuhë më të qartë dhe më të drejtpërdrejtë;
- ✓ duke shtuar shembuj konkretë;
- ✓ duke përdorur mjete stilistike (krahasime, përsëritje, metafora, shprehje frazeologjike, pyetje retorike etj.).

Produktet prezantohen dhe klasa diskuton si ndryshon ndikimi i mesazhit përmes stilit.

6) "Fjalimi pa gabime"

Nxënësve u jepet një tekst me gabime gjuhësore dhe formulime të paqarta. Ata:

- ✓ identifikojnë gabimet;
- ✓ riformulojnë fjalitë për qartësi;
- ✓ përmirësojnë shqiptimin (nëse lexohet me zë).

Diskutimi fokusohet te rëndësia e gjuhës së saktë për besueshmërinë e folësit.

7) "Nga tekst në video"

Nxënësit marrin një pjesë të fjalimit të tyre dhe e përshtatin për një video të shkurtër:

- ✓ e shkurtojnë mesazhin;
- ✓ përdorin fjali më të drejtpërdrejta;
- ✓ mendojnë për ritmin dhe qartësinë.

Ata prezantojnë të dyja versionet (klasik dhe digjital) dhe diskutojnë ndryshimet.

8) "IA si redaktor"

Nxënësit përdorin një mjet digjital/IA për të marrë sugjerime për strukturën ose stilin e fjalimit të tyre. Më pas ata:

- ✓ krahasojnë versionin e tyre me sugjerimet;
- ✓ zgjedhin vetëm ato që janë të dobishme;
- ✓ shpjegojnë pse i pranojnë ose i refuzojnë.

Diskutimi përqendrohet te përdorimi i ndërgjegjshëm i teknologjisë.

Tematika 5: Komunikimi joverbal

1) "Pa fjalë"

Mësuesi zgjedh disa nxënës që të komunikojnë një mesazh shumë të thjeshtë, pa përdorur fjalë, vetëm gjeste, mimikë dhe qëndrim. Pjesa tjetër e klasës:

- ✓ përpiqet të kuptojë mesazhin;
- ✓ diskuton sa i qartë ishte komunikimi;
- ✓ identifikon cilat elemente joverbale e bënë mesazhin të kuptueshëm ose jo.

Diskutimi përqendrohet te fakti që komunikimi joverbal shpesh është po aq i rëndësishëm sa ai verbal.

2) "I njëjti tekst, ndikim i ndryshëm"

Nxënësit marrin një tekst të shkurtër dhe e paraqesin në mënyra të ndryshme:

- ✓ me entuziazëm;

- ✓ me indiferencë;
- ✓ me ironi.

Klasa diskuton si ndryshon kuptimi në varësi të:

- ✓ tonit të zërit;
- ✓ shprehjes së fytyrës;
- ✓ gjesteve.

Kjo i ndihmon nxënësit të kuptojnë fuqinë e komunikimit joverbal në interpretimin e mesazhit.

3) "Pasqyra"

Nxënësit punojnë në çifte. Njëri kryen një prezantim të shkurtër, ndërsa tjetri vepron si "pasqyrë", duke imituar qëndrimin, gjestet dhe mimikën e tij.
Pas ushtrimit, ata diskutojnë:

- ✓ Cilat gjeste ishin të natyrshme dhe cilat jo?
- ✓ Cilat lëvizje ndihmonin mesazhin dhe cilat e shpërqendronin?
- ✓ Si ndikon qëndrimi i trupit në besueshmërinë e folësit?

4) "Prezantimi me kufizime"

Nxënësit mbajnë një prezantim të shkurtër, por me një kusht të veçantë (p.sh., pa lëvizur nga vendi, pa përdorur duart ose pa mbajtur kontakt të vazhdueshëm me sy).
Qëllimi është të kuptojnë:

- ✓ rolin e çdo elementi joverbal;
- ✓ si ndikon mungesa e tij në komunikim;
- ✓ si mund të përdoret në mënyrë të balancuar.

5) "Lexo audiencën"

Një nxënës prezanton, ndërsa klasa jep sinjale joverbale të ndryshme (interes, mërzi, hutim, mosmarrëveshje). Folësi:

- ✓ duhet të vërejë këto sinjale;
- ✓ duhet të përshtatë ritmin, tonin ose mënyrën e shpjegimit;
- ✓ reagojë pa humbur qetësinë.

Në fund, diskutohet si ndikojnë reagimet e audiencës në mënyrën e prezantimit.

6) "Menaxho zërin dhe ritmin"

Nxënësit lexojnë ose prezantojnë një tekst të shkurtër duke eksperimentuar me:

- ✓ ritmin (shpejt/ngadalë);
- ✓ volumin e zërit;
- ✓ përdorimin e pauzave për theksim.

Klasa diskuton:

- ✓ kur pauzat ndihmojnë kuptimin;
- ✓ kur ritmi i shpejtë ose i ngadaltë e bën mesazhin më efektiv ose më të vështirë për t'u ndjekur.

7) "Përgjigju në vend"

Nxënësit vendosen në situata të improvizuara:

- ✓ një pyetje e papritur nga audienca;
- ✓ një ndërprerje gjatë prezantimit;
- ✓ një koment kritik.

Ata duhet të reagojnë:

- ✓ duke ruajtur qetësinë;
- ✓ duke respektuar audiencën;
- ✓ duke mbajtur kontakt me audiencën.

Diskutimi përqendrohet te vetëkontrolli dhe profesionalizmi në komunikim.

8) "Para kamerës"

Nxënësit realizojnë një video të shkurtër (1-2 minuta), duke u fokusuar te:

- ✓ pozicionimi në ekran;
- ✓ kontakti me "audiencën" përmes kamerës;
- ✓ mimika dhe gjestet;
- ✓ qartësia e zërit.

Videoja analizohet në klasë, duke diskutuar:

- ✓ Çfarë funksionon mirë në komunikimin para kamerës?
- ✓ Çfarë duhet përmirësuar?

9) "Transformo prezantimin"

Nxënësit marrin një prezantim të hartuar për klasën dhe e përshtatin për një prezantim online. Ata:

- ✓ duhet të reduktojnë lëvizjet e panevojshme;
- ✓ duhet të fokusohen më shumë te fytyra dhe zëri;
- ✓ duhet të përdorin gjuhë më të drejtpërdrejtë.

Krahasohen të dyja versionet dhe diskutohet ndryshimi i qasjes.

10) Reflektim

Nxënësit reflektojnë mbi performancën e tyre:

- ✓ Cilat elemente joverbale përdorin më mirë?
- ✓ Çfarë duhet të përmirësojnë (kontakt me sy, gjeste, qëndrim)?
- ✓ Si ndryshon prezantimi i tyre në klasë dhe online?

Tematika 6: Menaxhimi i ankthit dhe i emocioneve

1) "E njoh ankthin tim"

Nxënësit plotësojnë individualisht një listë të shkurtër reflektimi:

- ✓ Çfarë ndiej para se të flas para të tjerëve?
- ✓ Çfarë ndodh me trupin tim (rrahje zemre, djersitje, zë i pasigurt)?
- ✓ Çfarë më shqetëson më shumë (gabimi, gjykimi, harresa)?

Më pas, në grupe të vogla, ata diskutojnë përvojat e tyre dhe kuptojnë që ankthi është i përbashkët.
Diskutimi përmbyllet me identifikimin e situatave më sfiduese për secilin.

2) "Nga ankth në energji"

Mësuesi prezanton idenë që ankthi mund të shndërrohet në energji pozitive. Nxënësit marrin situata konkrete (p.sh., prezantim para klasës, përgjigje në publik) dhe:

- ✓ duhet të identifikojnë emocionin negativ;
- ✓ duhet ta riformulojnë në një mendim pozitiv (jam i stresuar → jam i përgatitur dhe gati).

Në fund, ndajnë strategjitë e tyre dhe diskutojnë cilat janë më efektive.

3) "Frymëmarrja që të stabilizon"

Zhvillohet një ushtrim me nxënësit, të cilët:

- ✓ praktikojnë frymëmarrje të thellë (4 sekonda frymëmarrje - 4 mbajtje - 4 nxjerrje);
- ✓ më pas mbajnë një prezantim shumë të shkurtër.

Diskutohet ndryshimi:

- ✓ Si u ndjenë para dhe pas ushtrimit?
- ✓ Si ndikoi në qartësinë dhe sigurinë gjatë të folurit?

4) "Prezantimi i papërgatitur"

Mësuesi u jep nxënësve një temë për prezantim dhe ata kanë 1-2 minuta për t'u përgatitur. Nxënësit prezantojnë shkurt dhe fokusohen te:

- ✓ ruajtja e qetësisë;
- ✓ organizimi i shpejtë i ideve;
- ✓ vazhdimi i komunikimit edhe në pasiguri.

Diskutimi përqendrohet te mënyrat si mund të menaxhohet ankthi në situata të papritura.

5) "Gabimi nuk është fundi"

Gjatë një prezantimi, mësuesi ose nxënësit ndërhyjnë qëllimisht me:

- ✓ pyetje të papritura;
- ✓ ndërprerje;
- ✓ komente.

Nxënësi:

- ✓ duhet të ruajë qetësinë;
- ✓ duhet të përgjigjet me respekt;
- ✓ duhet të rikthehet te mesazhi.

Në fund, klasa diskuton se cilat strategji ndihmuan më shumë.

6) "Vizualizo suksesin"

Nxënësit udhëzohen të mbyllin sytë dhe të imagjinojnë një prezantim të suksesshëm:

- ✓ si flasin;
- ✓ si i përgjigjet audienca;
- ✓ si ndihen gjatë dhe pas prezantimit.

Më pas, ata ndajnë përvojën dhe lidhin vizualizimin me performancën reale.

7) "Nga draft në performancë"

Nxënësit përgatisin një prezantim të shkurtër dhe e realizojnë dy herë:

- ✓ hera e parë (me pasiguri);
- ✓ hera e dytë (pas feedback-ut dhe reflektimit).

Klasa analizon ndryshimin në:

- ✓ siguri;
- ✓ qartësi;
- ✓ kontroll emocional.

8) "Prezantim para kamerës"

Nxënësit regjistrojnë një video të shkurtër. Më pas:

- ✓ e shohin vetë dhe identifikojnë momentet ku duken të pasigurt;
- ✓ diskutojnë si ndryshon ndjesia kur nuk ka audiencë fizike;
- ✓ japin sugjerime për përmirësim.

9) "Mbështet folësin"

Pas çdo prezantimi, nxënësit japin feedback sipas strukturës:

- ✓ një gjë që funksionoi shumë mirë;
- ✓ një gjë që mund të përmirësohet;
- ✓ një sugjerim konkret.

Kjo krijon një mjedis të sigurt dhe ndihmon në uljen e ankthit.

10) Reflektim

Në fund, nxënësit reflektojnë:

- ✓ Çfarë i ndihmoi më shumë për të menaxhuar ankthin?
- ✓ Cilat strategji do të përdorin në të ardhmen?
- ✓ Si ka ndryshuar mënyra si e shohin të folurit në publik?

Tematika 7: Mjetet pamore dhe teknologjitë digjitale

1) "Çfarë nuk shkon?"

Mësuesi paraqet disa slide të ndryshme, të cilat përmbajnë probleme si mbingarkesë teksti, mungesë qartësie apo përdorim joefektiv i elementeve vizuale. Nxënësit, në grupe, analizojnë çdo slide duke identifikuar:

- ✓ çfarë e bën të vështirë për t'u kuptuar;
- ✓ cilat elemente janë të panevojshme;
- ✓ si mund të përmirësohet.

Në vijim, ata rregullojnë disa slide problematike dhe e prezantojnë versionin e përmirësuar, duke argumentuar zgjedhjet e tyre.

2) "6 slide, 1 mesazh"

Nxënësit krijojnë një prezantim shumë të shkurtër (6 slide) për një temë të caktuar. Ata udhëzohen të përfshijnë vetëm idetë kryesore dhe të përdorin elemente vizuale që i mbështesin ato.
Në fund, prezantimet diskutohen në klasë, duke u fokusuar te qartësia, përzgjedhja e informacionit dhe shmangia e mbingarkesës.

3) "Mos e lexo slide-in!"

Nxënësit prezantojnë slide-t e tyre, por pa i lexuar drejtpërdrejt. Ata duhet të flasin lirshëm dhe të përdorin slide-t vetëm si mbështetje.
Pjesa tjetër e klasës vëzhgon dhe vlerëson nëse:

- ✓ prezantimi është i qartë;
- ✓ slide-t ndihmojnë apo e pengojnë komunikimin;
- ✓ folësi ruan lidhjen me audiencën.

4) "Nga tekst në vizual"

Nxënësve u jepet një tekst i shkurtër informues. Ata duhet ta shndërrojnë atë në një formë vizuale (slide, skemë, grafik), duke përzgjedhur vetëm informacionin më të rëndësishëm.
Në fund, krahasohet versioni fillestar me atë të transformuar dhe diskutohet si ndikon kjo në kuptueshmërinë e mesazhit.

5) "Shikoje veten"

Nxënësit regjistrojnë një prezantim të shkurtër dhe më pas e analizojnë atë. Ata vlerësojnë:

- ✓ qartësinë e të folurit;
- ✓ mënyrën si përdoren slide-t;
- ✓ lidhjen midis të folurit dhe elementeve vizuale.

Në vijim, ata përmirësojnë prezantimin dhe realizojnë një version të dytë.

6) "Prezantimi për ekran"

Nxënësit marrin një prezantim të menduar për klasë dhe e përshtatin për një audiencë online. Ata:

- ✓ duhet të thjeshtojnë përmbajtjen;
- ✓ duhet të përdorin më shumë elemente vizuale;
- ✓ duhet ta bëjnë mesazhin më të drejtpërdrejtë.

Në fund, prezantojnë të dyja versionet dhe diskutojnë ndryshimet.

7) "Ndihma e teknologjisë"

Nxënësit përdorin mjete digjitale për të përmirësuar një pjesë të prezantimit të tyre (p.sh., për organizimin e ideve ose për përmirësimin e gjuhës). Ata analizojnë sugjerimet e marra dhe vendosin cilat janë të dobishme. Diskutimi përqendrohet te përdorimi i ndërgjegjshëm dhe kritik i teknologjisë.

8) "Prezantimi i plotë"

Nxënësit realizojnë një prezantim të plotë ku kombinojnë të folurin me elemente pamore dhe digjitale. Gjatë prezantimit vëzhgohet:

- ✓ qartësia e strukturës;
- ✓ përdorimi i slide-ve;
- ✓ ndikimi i komunikimit.

Pas prezantimit, klasa jep vlerësime dhe sugjerime për përmirësim.

Tematika 8: Llojet e fjalimeve dhe vlerësimi

1) "Cili lloj është?"

Mësuesi paraqet fragmente të shkurtra fjalimesh (të shkruara ose video). Nxënësit, në grupe:

- ✓ duhet të identifikojnë llojin e fjalimit (informues, bindës, për raste të veçanta);
- ✓ duhet të argumentojnë zgjedhjen e tyre;
- ✓ duhet të dallojnë elementet kryesore (informacion, argument, emocion).

Diskutimi përqendrohet te dallimet midis llojeve dhe qëllimi i secilit.

2) "E njëjta temë, dy fjalime"

Nxënësit marrin një temë të përbashkët (p.sh. përdorimi i teknologjisë) dhe duhet të krijojnë:

- ✓ një fjalim të shkurtër informues;
- ✓ një fjalim të shkurtër bindës,

Ata prezantojnë versionet dhe klasa diskuton si ndryshon:

- ✓ struktura;

- ✓ gjuha;
- ✓ mënyra e ndikimit te audienca.

3) "Analizo një fjalim të njohur"

Nxënësit punojnë me një fjalim të njohur (nga lista e dhënë më lart). Në grupe, ata analizojnë:

- ✓ strukturën (hyrje-zhvillim-përfundim);
- ✓ mënyrën e përdorimit të argumenteve dhe të emocioneve;
- ✓ ndikimin te audienca.

Në fund, prezantojnë analizën dhe nxjerrin elementet që e bëjnë fjalimin efektiv.

4) "Vlerëso si një ekspert"

Pas çdo prezantimi, nxënësit japin vlerësime dhe sugjerime për njëri-tjetrin, duke u mbështetur në kritere të qarta:

- ✓ çfarë ishte e qartë dhe e suksesshme;
- ✓ çfarë mund të përmirësohet;
- ✓ një sugjerim konkret.

Mësuesi udhëzon që komentet të jenë të sakta, të argumentuara dhe ndihmuese. Në fund, nxënësit reflektojnë mbi performancën e tyre dhe përmirësimet e mundshme.

5) "Vlerëso si një jurist"

Nxënësit ndjekin një ose disa fjalime dhe kanë për detyrë t'i vlerësojnë ato duke përdorur një tabelë me kritere të qarta. Para prezantimeve, mësuesi shpjegon kriteret dhe mënyrën e vlerësimit, duke theksuar që komentet duhet të jenë konkrete dhe ndihmuese. Gjatë prezantimit, çdo nxënës plotëson tabelën për një folës të caktuar. Pas përfundimit, nxënësit diskutojnë vlerësimet e tyre dhe japin feedback të argumentuar, duke u fokusuar te përmirësimi.

Kriteri	1 Fillestar	2 Në zhvillim	3 Mirë	4 Shumë mirë
Qartësia e mesazhit	Mesazhi është i paqartë dhe i vështirë për t'u kuptuar.	Mesazhi kuptohet pjesërisht.	Mesazhi është i qartë në pjesën më të madhe.	Mesazhi është shumë i qartë gjatë gjithë fjalimit.
Organizimi i ideve	Nuk ka strukturë të dukshme.	Ka përpjekje për strukturë.	Ide të organizuara mirë.	Strukturë shumë e qartë dhe logjike.
Përshtatja me audiencën	Nuk merret parasysh audienca.	Përshtatje e kufizuar me audiencën.	Përshtatje e mirë me audiencën.	Përshtatje shumë e mirë me audiencën.
Gjuha dhe stili	Gjuhë e pasaktë ose e papërshtatshme.	Disa pasaktësi.	Gjuhë e qartë dhe e përshtatshme.	Gjuhë shumë e saktë, e pasur dhe shprehëse.
Mënyra e prezantimit	I pasigurt, pa kontakt me audiencën.	Pak kontakt dhe kontroll.	Prezantim i mirë.	Prezantim shumë i sigurt dhe bindës.

Në fund të veprimtarisë, nxënësit:

- ✓ krahasojnë vlerësimet;
- ✓ diskutojnë dallimet në gjykim;
- ✓ reflektojnë mbi performancën e tyre dhe përmirësimet e mundshme.

Tematika 9: Realizimi i produktit final

1) "Zgjedh dhe justifikoj temën"

Nxënësit shqyrtojnë listën e temave të propozuara dhe përzgjedhin një temë që lidhet me interesat dhe përvojën e tyre. Çdo nxënës paraqet shkurtimisht zgjedhjen e tij, duke shpjeguar:

- ✓ pse e ka zgjedhur këtë temë;
- ✓ cilën audiencë synon;
- ✓ cili është qëllimi i fjalimit (informues, bindës apo ndërgjegjësues).

Klasa dhe mësuesi japin sugjerime për qartësimin dhe përmirësimin e formulimit të temës.

2) "Hulumto dhe përzgjidh"

Nxënësit kërkojnë informacion për temën e tyre nga burime të ndryshme (libra, artikuj, burime digjitale). Ata përzgjedhin vetëm informacionin më të rëndësishëm dhe:

- ✓ evidentojnë faktet, shembujt dhe argumentet kryesore;
- ✓ shmangin informacionin e tepërt ose të pasaktë;
- ✓ organizojnë materialin në formë skeme.

Në fund, prezantojnë shkurtimisht gjetjet dhe marrin sugjerime për përmirësim.

3) "Hartoj fjalimin tim"

Nxënësit hartojnë strukturën e fjalimit:

- ✓ hyrjen (që tërheq vëmendjen);
- ✓ zhvillimin (idetë kryesore të organizuara logjikisht);
- ✓ përfundimin (mesazh i qartë dhe ndikues).

Ata punojnë me skema dhe drafte, duke u fokusuar te lidhja midis ideve dhe rrjedhshmëria e fjalimit. Drafti i fjalimit diskutohet në grupe dhe përmirësohet para prezantimit.

4) "Prova gjenerale"

Nxënësit bëjnë një provë të parë të fjalimit para një grupi të vogël. Gjatë provës, vëzhgohen:

- ✓ qartësia e mesazhit;
- ✓ mënyra e prezantimit;
- ✓ përdorimi i gjuhës dhe i elementeve joverbale.

Nxënësit marrin vlerësime dhe sugjerime nga shokët dhe mësuesi dhe bëjnë përmirësimet përfundimtare.

5) "Prezantimi final"

Në prezantimin final nxënësit mund të ftojnë prindër, mësues, nxënës nga klasat e tjera etj. Nxënësit prezantojnë fjalimin e tyre. Gjatë prezantimit, ata:

- ✓ përdorin argumente dhe shembuj për të mbështetur idetë;
- ✓ përshtatin mënyrën e të folurit sipas audiencës;

- ✓ përdorin, nëse është e nevojshme, mjete pamore për mbështetje.

Mësuesi dhe nxënësit ndjekin me vëmendje prezantimet dhe mbajnë shënime për vlerësim.

6) "Vlerëso dhe reflekto"

Pas prezantimeve, nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin duke u mbështetur në kritere të qarta (qartësia, organizimi, prezantimi, përdorimi i gjuhës). Ata japin komente konkrete dhe ndihmuese.

Në fund, çdo nxënës reflekton:

- ✓ Çfarë shkoi mirë?
- ✓ Çfarë duhet të përmirësojë?
- ✓ Çfarë aftësish zhvilloi gjatë modulit?

9. SHPËRNDARJA SUGJERUESE E ORËVE SIPAS TEMATIKAVE

Ndarja e orëve sipas tematikave është sugjeruese dhe mund të përshtatet nga mësuesi në varësi të nevojave të klasës dhe ritmit të të nxënit. E rëndësishme është që të respektohet totali i përgjithshëm prej 36 orësh për zhvillimin e modulit.

Nr.	Tematikat	Orë
1	Të folurit në publik si proces komunikimi dhe etika	3 orë
2	Analiza e audiencës	2 orë
3	Zgjedhja e temës, qëllimit dhe hulumtimi	4 orë
4	Organizimi, struktura dhe stili	6 orë
5	Komunikimi joverbal	3 orë
6	Menaxhimi i ankthit dhe i emocioneve	3 orë
7	Mjetet pamore dhe teknologjitë digjitale	3 orë
8	Llojet e fjalimeve dhe vlerësimi	5 orë
9	Realizimi i produktit final	7 orë
TOTALI		36 orë[1]

[1] Në klasën XII, moduli zhvillohet në 34 orë mësimore.

10. PRODUKTI FINAL I MODULIT “TË FOLURIT NË PUBLIK”

Moduli përmbyllet me realizimin e një *fjalimi të strukturuar,* i cili prezantohet nga nxënësit përpara klasës ose në një format digjital (video, prezantim online).

Çdo nxënës përzgjedh një temë nga fushat ndërkurrikulare dhe ndërton një fjalim të qartë, të argumentuar dhe të përshtatur për audiencën, duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë modulit (strukturimi i ideve, përdorimi i gjuhës, komunikimi joverbal dhe mjetet mbështetëse).

Si aktivitet përmbyllës, mund të organizohet një seancë prezantimesh ose konkurs mes klasash, ku nxënësit prezantojnë fjalimet e tyre dhe marrin vlerësim përmes feedback-ut nga mësuesi dhe bashkëmoshatarët.

Ky produkt final shërben për të demonstruar në praktikë aftësitë e zhvilluara në të folurin në publik dhe për të nxitur shprehjen e ideve mbi çështje që lidhen me jetën dhe shoqërinë.

11. BIBLIOGRAFIA

- Anderson, C. (2016). *TED Talks: Udhëzuesi zyrtar për të folurit në publik*. Houghton Mifflin Harcourt.
- Aristoteli. (2004). *Retorika*. Dudaj.
- Beebe, Steven A., & Beebe, Susan J. (2018). *Public Speaking: An Audience-Centered Approach*. Boston: Pearson.
- Carnegie, D. (1962). *Mënyra e shpejtë dhe e lehtë për të folur në mënyrë efektive*. Simon & Schuster.
- Covey, S. R. (2004). *7 zakonet e njerëzve shumë efektivë*. Botimet Dudaj.
- Gallo, C. (2014). *Flit si në TED: 9 sekretet e të folurit në publik nga folësit më të mirë në botë*. St. Martin's Press.
- Lucas, S. E. (2020). *Arti i të folurit në publik* (botimi i 13-të). McGraw-Hill Education.
- Mujaj, A. (2012). *Formimi retorik*. Dukagjini.
- Osborn, Michael, Osborn, Suzanne, & Osborn, Randall (2014). *Public Speaking*. Boston: Pearson.
- Pink, D. H. (2012). *Të bindësh është njerëzore*. Riverhead Books.
- TED Talks (www.ted.com) - modele fjalimesh bashkëkohore.
- Toastmasters International (www.toastmasters.org) - udhëzime për zhvillimin e të folurit publik
- Verderber, Rudolph F., Verderber, Kathleen S., & Sellnow, Deanna D. (2016). *The Challenge of Effective Speaking*. Boston: Cengage Learning.